

RAPORT STUDIMOR

INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK NGA PUSHTETI VENDOR

BASHKIA VLORË



QENDRA RINORE E VLORËS
QERSHOR 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	3
2. LISTA E SHKURTIMEVE	4
3. PROFILI I BASHKISË VLORË	5
4. METODOLOGJIA	8
5. ANALIZA E TE GJITHA MEDIUMEVE DHE FORMAVE PER INFORMIMIN, NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN	9
7. GJETJE NGA ANKETIMI ME BASHKITË DHE KESHILLAT BASHKIAKË	14
8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	21
9. ANEKSE	23
PYETËSOR ME DREJTUES DHE NËPUNËS TË BASHKISË	23
PYETËSOR ME KËSHILLTARË BASHKIAKË	27

1. HYRJE

Raporti studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” kryhet në kuadër të projektit “Përballja e Ofertave Politike – POP”. Ai është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe nga National Endowment for Democracy.

Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë) dhe që prej atij viti rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” monitoron zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri-tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Në vitin 2021, Rrjeti POP u zgjerua duke shtuar edhe bashkitë Elbasan, Vau i Dejës dhe Korçë. Tre Kontrata Sociale u nënshkruan në bashkitë e mësipërme duke vijuar kështu monitorimin për zbatimin e tyre në 12 bashki. Nëpërmjet këtij projekti, Rrjeti POP synon të forcojë bashkëpunimin me qytetarët në përfshirjen e tyre në vendimmarrje në nivel vendor, duke qenë një urë lidhëse mes tyre (qytetarëve) dhe pushtetit vendor për sa i përket transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë vendore.

Organizatave të Rrjetit POP gjatë periudhës maj-qershor 2022 realizuan pyetësorë me stafet përkatëse në Bashki dhe me përfaqësues të Këshillave Bashkiakë dhe përgjigjet e marra nga pyetësorët u përballën me analizën e bërë nga vetë shoqatat sa i përket gjendjes aktuale në secilën bashki në lidhje me mënyrën se si realizohet dhe mjetet e format që bashkitë përdorin për njoftimin, informimin dhe konsultimin e publikut.

Kjo analizë tregoi që bashkitë i vlerësojnë këto procese dhe përpiqen të përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të patur qytetarët dhe qytetarët pjesë të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së tyre, por ka dhe sfida që duhen tejkaluar e mangësi të cilat duhen përmirësuar.

Për shembull faqet zyrtare të bashkive duhen të jenë më miqësore për publikun, regjistri i kërkesë ankesave duhet të përditësohet vazhdimisht, programet e transparencës duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të konsultohen me qytetarët, bashkitë duhet të përdorin një numër të konsiderueshëm mjetesh dhe formash për njoftimin dhe informimin e qytetarëve. Proceset e konsultimeve realizohen në bashkitë pjesëmarrëse por më shumë duhet të punohet për rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t’u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP” synon të rrisë debatin publik dhe informacionin të qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Është një përpjekje për të rritur hapësirat për debate publike dhe informacione të qytetarëve në lidhje me platformat e politikave nga njëra anë dhe duke i orientuar këto platforma drejt nevojave dhe përparësive të komunitetit nga ana tjetër.

2. LISTA E SHKURTIMEVE

POP	Përballja e Ofertave Politike
NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
Nj.A	Njësi Adminsitrative
RAT	Reforma Administrative-Territoriale
BP	Buxhetimi me Pjesëmarrje
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
KB	Këshilli Bashkiak
VKB	Vendime të Këshillit Bashkiak
OPIC	Qendra Ndërkombëtare Olof Palme
NED	National Endowment for Democracy
VYC	Qendra Rinore e Vlorës
QAGJZH	Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile

3. PROFILI I BASHKISË VLORË

Informacion i përgjithshëm: Riorganizimi i Bashkisë Vlorë si rezultat i Reformës Administrativo-Territoriale solli ndryshime të ndjeshme si në popullsi ashtu edhe në territore. Territorët e Bashkisë u zmadhuan me 23 herë (nga 27 km² në 616.85 km²) dhe popullsia u rrit me gati 54%, ndërsa renditet e gjashta në rang kombëtar përsa i përket numrit të popullsisë.

Bashkia Vlorë përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Vlorë, Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë dhe Shushicë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e Qarkut të Vlorës. Bashkia ka nën administrimin e saj dy qytete (Vlorë dhe Orikum) dhe 37 fshatra; në listën e fshatrave përfshihet edhe Sazani. Bashkia e re e Vlorës kufizohet në veri me bashkinë Fier, në lindje me bashkinë Selenicë dhe në jug me bashkinë Himarë. Në këtë territor shtrihen qendra të rëndësishme të turizmit detar: Vlora, Narta, Radhima dhe Orikumi. Kjo zonë ka në përbërje dhe parkun detar-bregdetar Sazan-Karaburun, që është i vetmi i këtij lloji në vendin tonë, dhe Peisazhin e Mbrojtur të sistemit ligatinor Vjosë-Nartë.

Popullsia: Bashkia e Vlorës ka një sipërfaqe prej 616.85 km². Nga të dhënat e Census, densiteti i popullsisë në këtë bashki është 169.9 banorë për km² ndërsa sipas të dhënave të regjistrit civil, densiteti është 314.73 banorë për km². Nga të dhënat e ndryshimeve sipas NJ. A. vihet re se pjesa urbane e Bashkisë Vlorë përfaqësohet nga Bashkia e vjetër e Vlorës e cila ka pësuar rritje, krahasuar me rënien e popullsisë në NJ.A. Orikum, Novoselë, Shushicë dhe Qendër. Duke u nisur nga shtrirja e Njësive Territoriale të Bashkisë Vlorë, shpërndarja e popullsisë së Regjistrit të Gjendjes Civile na jep dhe një shpërndarje të popullsisë qytet-fshat. Në zonat urbane, kryesisht në qytetin e Vlorës janë të regjistruar rreth 71% e popullsisë, ndërsa popullsia në zonat rurale dhe gjysmë urbane (Orikum), përfshin rreth 29% e popullsisë.

Sipas Census të vitit 2011, bashkia Vlorë ka 104.827 banorë (Burimi: INSTAT). Gjithsesi, në regjistrin civil në këtë bashki rezulton për vitin 2021 si popullsi banuese 203561 banorë (Burimi: Gjendja Civile Bashkia Vlorë).

Nr	Njësia Administrative	Numri i banorëve	Numri i familjeve
1	Bashkia Vlorë	145562	49771
2	Njësia Administrative Novoselë	17402	4928
3	Njësia Administrative Qendër	18836	5317
4	Njësia Administrative Shushicë	9785	2974
5	Njësia Administrative Orikum	11976	3720
	Popullsia Totale	203561	66710

Tab.1 Popullsia totale për vitin 2021 Burimi i informacionit: Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Vlorë

Struktura: Bashkia e Vlorës përbëhet nga kryetari, një nën/kryetare, 9 administratore (3F/6M) të rajoneve dhe Nj.A-ve si dhe 18 drejtorë/e drejtorie (9F/9M) si dhe 10 drejtori (4F/6M) të institucioneve të varësisë. Këshilli Bashkiak përbëhet nga 49 këshilltarë (25F/24M) nga 51 që parashikon ligji. Pozicioni i sekretarit të Këshillit Bashkiak është vakant, ndërsa është ngritur dhe një sekretariat që përbëhet nga dy specialistë (1F/1M)

Numri i Punonjësve të Bashkisë	Vitet	2017	2018	2019	2020	2021	2022
	Total	955	955	955	1,006	1,182	1212
<i>Administrata e Bashkisë</i>		346	346	276	297	345	382
<i>Njësitë Shpenzuese</i>		609	609	679	709	837	830

Në administratën e Bashkisë Vlorë për vitin 2022, janë të punësuar 382 persona, ndërsa pjesa tjetër janë punonjës së institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara. Nga përlogaritjet që ka bërë ekipi i projektit, në total struktura e Bashkisë Vlorë për vitin **2022**, është **1212 punonjës**. (numri i të punësuarve të Bashkisë Vlorë është gjeneruar nga vendimet e KB)

Zhvillimi Ekonomik: Qyteti i Vlorës është qendër e madhe demografike zhvillimi dhe punësimi, si dhe porti i dytë më i madh në Shqipëri; në të gjendet dhe një port peshkimi dhe një qendër industriale dhe tregtare që gjeneron të ardhura të lidhura me shërbimin dhe prodhimin. Ekonomia e qytetit është e lidhur me ekonominë e portit, ndërtimit, turizmit dhe shërbimeve të tjera përkatëse. Bashkia e Vlorës në zonën urbane të saj është planifikuar edhe si zonë industriale dhe petrolifere. Në Bashkinë e Vlorës veprojnë më shumë se 5324 biznese ose subjekte, ku të ardhurat nga këto biznese përbëjnë dhe zërin kryesor në buxhetin e bashkisë. Gjatë 2021 nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore ka reflektuar të dhënat në lidhje me numrin e subjekteve të regjistruara aktive. Tabela e mëposhtme paraqet një informacion mbi strukturën e numrit të subjekteve aktive 2019-2021

NR	Bashkia Vlore	Subjekte	Subjekte	Subjekte
		2019	2020	2021
1	TP sh. pakice	2734	2,782	2766
2	TP sh. shumice	191	207	206
3	TP shërbim	866	910	899
4	TP p.lira	302	314	364
5	TP BM ad.kryesore	572	551	601
6	TP BM ad.dytesore	490	496	488
7	TP Prodhim			
8	Ojf			
	TOTALI	5155	5260	5324

Zhvillimi Turistik: Pozicionimi gjeografik i territorit të Bashkisë Vlorë në drejtim të zhvillimit të turizmit, veçanërisht me zgjerimin e saj me ish komunat që nga grykëderdhja e Vjosës e deri në malësinë e Llogarasë, kanë shtuar mjaft larmishmërinë dhe potencialin turistik të saj. Pozicioni i përshtatshëm gjeografik me praninë e bregdetit të Jonit dhe Adriatikut në të njëjtën bashki, ekzistenca e shumë monumenteve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore, identifikon këtë territor si zonë me potenciale të spikatura të zhvillimit të turizmit balnear, agro-turizmit, aktiviteteve të peshkimit turistik, etj.

Sektori i turizmit është një fushë prioritare në fokusin e Bashkisë së Vlorës për shkak të kontributit të tij të rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës, si dhe rritjen e njohurive dhe vetëdijes kulturore midis vendeve. Bashkia Vlorë ka zgjedhur turizmin si një sektor kryesor dhe si një katalizator i rritjes ekonomike. Kjo zgjedhje është mbështetur nga një numër i lartë i investimeve private dhe publike në aktivitetet e turizmit, kryesisht në strukturat akomoduese.

Ndihma dhe Shërbimet Sociale: Në Bashkinë Vlorë 865 familje janë përfituese nga skema e pagesës së ndihmës ekonomike, ku rreth 29% e tyre janë të komunitetit rom dhe egjiptian, 689 individë të komunitetit rom dhe egjiptian janë përfitues të ndihmës ekonomike, ku rreth 48% e tyre janë femra, 1933 individë janë përfitues nga skema e pagesës për aftësi të kufizuar dhe 15 fëmijë trajtohen nga Shtëpia e Foshnjës.

Përfitues nga skema e pagesës së ndihmës ekonomike janë 865 familje nga të cilat 251 familje i përkasin komunitetit R/E. Gjithashtu nga e njëjta paketë përfitojnë edhe 689 individë (329F/360M)

Njësia për çështjet e dhunës në familje dhe barazisë gjinore ka trajtuar për vitin 2021 në bashkëpunim me Ekipin Teknik Ndërdisciplinar 228 raste dhune me vendim gjykatë. Grupmosha 36-45 vjeç, niveli arsimor i ulët dhe personat me status civil të martuar kanë qenë kategoritë më të prekuara nga fenomeni i dhunës në familje.

Programet sociale të strehimit: Programet e strehimit të cilat janë zbatuar në Bashkinë Vlorë gjatë 3 viteve të fundit, 2019, 2020 dhe 2021, nga të cilat kanë përfituar familje dhe individë që renditen: Programi i subvencionimit të qirasë; Programi i pëmirësimit të kushteve të banimit dhe Programi i banesave me kosto të ulët. Sipas plotësimit të kushteve dhe verifikimit në terren, për vitin 2021 rreth 30% e përfituesve të programit të subvencionimit të qirasë janë të komunitetit rom dhe egjiptian, ndërsa pjesa e përket programit të pëmirësimit të kushteve të banimit, përfitues ndër vite kanë qenë vetëm të komunitetit rom dhe egjiptian.

Programi i subvencionimit të qirasë			
Vitet	Aplikues	Përfitues	
		Total	R/E
2019	37	29	16
2020	47	34	15
2021	48	39	12

Programi i pëmirësimit të kushteve të banimit			
Vitet	Aplikues	Përfitues	
		Total	R/E
2019	41	34	34
2020	0	29	29
2021	13	6	6

Programi i banesave me kosto të ulët		
Vitet	Aplikues	Përfitues
		Total
2019	219	60
2020	156	78
2021	177	Në proces

Burimi i informacionit: Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, Bashkia Vlorë

4. METODOLOGJIA

Për hartimin e raportit mbi situatën e informimit, njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Vlorë janë kërkuar dhe përdorur një seri teknikash dhe instrumentash, të tilla si: a) hartimi i metodologjisë dhe instrumentit të anketimit (dy pyetësorë); b) kërkim dhe analizim të informacionit, dokumentave (fizikë dhe elektronikë) dhe kuadrit rregullator e ligjor përkatës; c) intervista të thëlluara me stafin e bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; d) analizim dhe përpunim të të dhënave të anketimit dhe e) përgatitja e raportit së bashku me rekomandimet përkatëse.

Ekspertët e projektit e bazuan procesin e kërkimit dhe analizimit në tërësinë e informacionit, dokumentacionit dhe praktikave, të përdorura në procese të ndryshme të njoftimit, informimit, konsultimit dhe angazhimit të komunitetit në bashkëqeverisje dhe vendimmarrje. Procesi i kërkimit dhe analizimit u shtri si në dokumencionin ekzistues zyrtar, ashtu edhe në kuadrin respektiv rregullator e ligjor, të tilla si Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, etj. Identifikimi dhe analiza e burimeve ekzistuese tregoi se ka pak informacion dhe të dhëna të disonueshme mbi praktikën e përfshirjes qytetare në qeverisjen vendore.

Pamjaftueshmëria e informacionit të disponueshëm mbi çështjen në fjalë theksoi rëndësinë e procesit të anketimit me të gjitha hallkat e veta (hartimi i metodologjisë, përcaktimi i rubrikave dhe informacionit që duhej mbledhur dhe analizuar, dhe format e mjetet që do të përdreshin për kryerjen e tij). Metoda kryesore për realizimin e studimit është ajo sasiore, që nënkupton përdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave. Anketimi përdori gjerësisht elemente të vlerësimit cilësor nëpërmjet pyetjeve të hapura dhe shpjeguese me qëllim eksplorimin e instrumenteve dhe proceseve që sigurojnë angazhim dhe gjithëpërfshirje të komuniteteve në pushtetin vendor. Metodologjia e studimit mbart elementë të fortë të vlerësimit informativ.

Pjesë e këtij anketimit janë drejtues, stafe teknike dhe këshilltarë vendorë të 12 bashkive të madhësive të ndryshme të përfshira në programet shumëvjeçare që Olof Palme ka zbatuar në vend. Për anketimin u hartuan dy pyetësorë me pyetje shteruese cilësore dhe sasiore, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë temash dhe çështjesh. Për përgatitjen e pyetësorëve u konsultuan paraprakisht ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse që përbëjnë kuadrin ligjor dhe institucional mbi informimin, njoftimin dhe konsultimin qytetar në nivel vendor.

Faza përmbyllëse përfshiu hedhjen, përpunimin statistikor, studimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe përgatitjen e këtij raportit përfundimtar.

5. ANALIZA E TE GJITHA MEDIUMEVE DHE FORMAVE PER INFORMIMIN, NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN

Informimi, njoftimi dhe konsultimi publik i qytetarëve nga Bashkitë dhe Këshillat Bashkiakë janë detyrime ligjore që rrjedhin nga legjislati, ndërsa janë edhe një formë e mirë e ushtrimit të demokracisë lokale ku zëri i qytetarëve dëgjohet.

Kuadri ligjor në fuqi parashikon një sërë detyrimesh dhe përgjegjësish në lidhje me format dhe mjetet që institucionet publike duhet të vënë në dispozicion për të ofruar dhe mundësuar pjesëmarrjen e publikut dhe grupeve të interesit në procesin e informimit, njoftimit dhe përfshirjes së tyre në konsultim e vendimmarrje.

Nga analiza e realizuar për këtë studim, vlerësojmë se Bashkia Vlorë dhe Këshilli Bashkiak përdorin forma të ndryshme për të informuar qytetarët, ndërsa ekzistojnë rregullore specifike apo programe për format e informimit, njoftimit dhe konsultimit publik.

Bazuar në kuadrin ligjor informimi, njoftimi dhe konsultimi i publikut nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak bëhet në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, ligjin 119/2014 'Për të drejtën e Informimit' dhe ligjin 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik". Për informimin e publikut Bashkia dhe Këshilli Bashkiak mundësojnë mekanizma dhe sisteme të informacionit për publikun, siç janë:

Faqen e internetit e Bashkisë: Është një faqe ku gjenden të inkorporuara të dhënat për Bashkinë Vlorë dhe Këshillin Bashkiak (www.vlora.gov.al).

Faqja e internetit nuk është interaktive, edhe pse në të janë hedhur vazhdimisht të dhëna dhe janë publikuar informacione e njoftime të nevojshme për qytetarët. Të dhënat për Bashkinë Vlorë janë të pastrukturuara, ndërsa në të njëjtën faqe gjenden edhe të dhënat e KB, që janë më të strukturuara dhe përmbajnë më shumë informacion. Një prej problemeve madhore që kemi identifikuar gjatë monitorimit është fakti se çdo dokument ligjor i ngarkuar në këtë faqe nuk ka mundësi të shkarkohet, duke u sjellë qytetarëve mungesë të informacioneve apo shërbimeve primare, që duhet të harxhojnë kohë për të patur akses në dokumente të rëndësishme siç është Plani i Përgjithshëm Vendor, Buxhetet Vjetore/Afatëmesëm dhe format e kërkesave, ankesave apo modele të tjera të nevojshme për të marrë shërbime nga Bashkia. E njëjta situatë ndodh edhe me dokumentet që miratohen nga Këshilli Bashkiak, ku qytetarët kanë akses vetëm në vendimet e aprovuara dhe jo në dokumentet sqaruese ose informuese në kohë reale. *Faqja e internetit e Bashkisë Vlorë ka nevojë për një staf të dedikuar dhe profesional që nxjerr në kohë reale çdo informacion apo vendimmarrje për publikun. Mbetet ende punë për tu bërë që faqja e bashkisë të jetë miqësore, e sigurt dhe me materiale të rifreskuara.*

Programi i Transparencës: Këshilli Bashkiak harton dhe miraton programin e transparencës në referencë të modelit të përgatitur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Programi i Transparencës i Bashkisë Vlorë është miratuar me Vendimin Nr.129 të Këshillit të Bashkisë Vlorë, datë 06.12.2018, ndërsa vlen të theksohet se nuk ka një koordinator të dedikuar për programin e transparencës, sic kërkon ligji 139/2015, neni 15, pika 3. Programi i Transparencës është një tjetër mekanizëm ku qytetarët kanë mundësi të marrin informacion, përmes faqes së bashkisë. Edhe pse në komunikim me publikun Bashkia Vlorë njofton se Programi i Transparencës nuk është një listë e plotë e burimeve të informacionit të mbajtura nga Bashkia Vlorë, ajo fton qytetarët që të kenë mundësi të formulojnë kërkesa për informacion, ankesa dhe vërejtje përmes dokumentacionit të shkruar dhe komunikimeve në postën elektronike. Për sa kohë këtë detyrë e zhvillon Koordinatorin e Informimit Publik, që në përditshmërinë e punës së tij/saj ka volum shumë të madh pune, ky program nuk mund të quhet i aplikueshëm nga Bashkia Vlorë, duke sjellë pengesa të vazhdueshme për informimin, transparencën dhe llogaridhënien e Bashkisë Vlorë ndaj qytetarëve të saj.

Ndërsa pjesë e Programit të Transparencës është edhe informacioni për Këshillin Bashkiak, përmes publikimit në faqen e Këshillit duke bërë transparencë për komunitetin për përbërjen dhe strukturën e Këshillit (anëtarët, Sekretarin e Këshillit, Komisionet e Këshillit, grupet e këshilltarëve) dhe kontaktet e këshilltarëve (<https://vlora.gov.al/keshilltaret-e-kb/>), listë që ka nevojë të rifreskohet herë pas here.

Regjistrat Elektronikë të Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë Vlorë: Në dy vitet e fundit regjistrat elektronikë i janë shtuar faqes së internetit të KB dhe Bashkisë Vlorë, ku ka një sesion të dedikuar ku publikohen të dhënat, por vlen të përmendet fakti se krahasuar me vendimmarrjen

e Bashkisë, në faqen e KB ka të dhëna më të rifreskuara dhe me informacione të bollshme. Gjithësesi në seksionin transparenca, publikohet në mënyrë të përditësuar regjistri i kërkesave për informacion për Bashkinë Vlorë ku të dhëna më të detajuara mund të gjenden në linkun <http://vlora.gov.al/kordinatori/regjistri-kerkesave-informacion/>.

Ndërsa në seksionin e Këshillit Bashkiak ka informacione të bollshme rreth rregjistrave elektronikë dhe informacioneve që kanë të bëjnë me format dhe procedurat e regjistrave të projekt-akteve; kërkesave dhe ankesave. Linku me të dhënat që janë publikuar në seksionin e KB, ndërsa si Bashkia Vlorë edhe KB i trajtojnë kërkesat, ankesat dhe vërejtjet. Gjithësesi nevojitet ende punë që të dhënat të jenë të përditësuara, por vlen të përmendet ky veprim pozitiv i publikimit të regjistrave online, falë edhe mbështetjes nga programi Bashki të Forta.

Në seksionin e KB, pranë faqes së internetit të Bashkisë Vlorë gjenden disa regjistra që janë: Regjistri i mbledhjeve të këshillit bashkiak; regjistri i ankesave, kërkesave dhe vërejtjeve (<https://vlora.gov.al/ankesa/>); regjistri i brendshëm i peticioneve dhe iniciativave qytetare (<https://vlora.gov.al/regjistri-i-brendshem-i-peticioneve-dhe-iniciativave-qytetare/>); regjistri i projekt-akteve për konsultim publik, të këshillit bashkiak (<https://vlora.gov.al/regjistri-i-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak/>); regjistri i mbledhjeve të këshillit bashkiak.

Regjistri i projekt-akteve publikohet në faqen e internetit të KB. Në këtë sesion publikohen vendimet, projekt-vendimet, procesverbalet dhe dëgjuesat publike që realizon Këshilli i Bashkisë Vlorë (<https://vlora.gov.al/category/proces-verbale-per-kb/>). Gjithësesi duke qenë në të njëjtën faqe të Bashkisë Vlorë ka nevojë ende që dokumentacioni të jetë miqësor për qytetarët dhe lehtësisht i kuptueshëm.

Stenda e njoftimeve publike dhe tabela informative: Stenda është e pozicionuar në hyrje të Bashkisë Vlorë, dhe aty shpallen gjithë njoftimet publike të këtij institucioni. Stenda ka përmasa të vogla dhe volumi i informacioneve që shpallen është i madh. Ndër të tjera edhe vendimet e KB shpallen në këtë stendë. Stenda/tabela informative, më saktë muret e godinave në pjesën hyrëse të tyre, ka dhe në çdo rajon dhe Nj.A të Bashkisë Vlorë.

Sporteli i Drejtorisë së Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun është struktura e parë që pret dhe menaxhon gjithë kërkesat dhe informacionet që kërkojnë qytetarët. Pranë kësaj drejtorie është pozicionuar edhe Koordinatorin për të Drejtën e Informimit. Në këtë drejtori, pasi priten kërkesat për informacion, ankesat dhe vërejtjet nga qytetarët shpërndahen në drejtoritë e tjera të Bashkisë dhe përpunohen përgjigjet me dokumentacionin përkatës brenda afatit ligjor. Për sa i përket numrit të kërkesave të regjistruara në regjistrin e posaçëm, sipas ligjit Nr.119/2014 “ Për të drejtën e informimit”, të cilat publikohen dhe përditësohen çdo tre muaj në faqen zyrtare të Autoritetit Publik në rubrikën “Transparenca” si dhe është implementuar regjistri elektronik i kërkesave për informacion, i cili është i aksesueshëm nga qytetarët për dërgim të kërkesave për informacion në portalin Pyet shtetin.al dhe që monitorohet çdo ditë nga ana e Drejtorisë, në total për vitin 2022, për periudhën janar-prill, kjo drejtori ka përpunuar 832 kërkesa dhe numri total i përgjigjeve është 39. Gjithashtu për periudhën janar-prill janë regjistruar 17 (shtatëmbëdhjetë) kërkesa për informacion, prej të cilave 5 (pesë) kanë

marrë përgjigje. Aktualisht Bashkia Vlorë është duke përfunduar procedurat për ngritjen e Zyrës me Një Ndalesë, mbështetur nga Star 3, ku ngritja e strukturës pritet të përmirësojë shërbimin e informimit të publikut dhe përpunimin e shpërndarjen e informacionit.

Media Sociale e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak: Duket që mediat sociale zënë një vend të rëndësishëm mes formave që bashkia dhe KB përdorin për njoftimin dhe përfshirjen qytetare. Ato rifreskohen në mënyrë periodike nga personat e ngarkuar për administrimin e tyre.

Dy faqe në FB, Bashkia Vlorë dhe Këshilli Bashkiak Vlorë, paraqesin informacion proaktiv mbi aktivitetet ditore që këto dy institucione kryejnë. Faqja e Bashkisë Vlorë në FB ka rreth 25,622 ndjekës, ndërsa faqja e KB ka rreth 1,642 ndjekës. Gjithsesi lajmet janë thjesht të natyrës informuese dhe në shumë pak raste ka mundësi të ndërveprosh. Faqja e KB është më institucionale ku qytetarët njoftohen për rendin e mbledhjes së KB dhe gjatë pandemisë janë mbajtur edhe online mbledhjet e KB, ndërsa faqja e Bashkisë Vlorë menaxhohet nga kabineti i kryetarit të Bashkisë ose persona të caktuar që nxjerrin në mënyrë periodike njoftime të rëndësishme për të informuar publikun për të marrë pjesë në procese të ndryshme.

Botimet periodike/buletinë informues të printuar ose online, janë praktika që nuk ndiqen në Vlorë, as nga Bashkia e as nga KB. Fakti që në Vlorë prej vitesh nuk ka gazetë lokale të printuar/ online, nuk ka nxitur te institucionet lokale kërkesën për të përmirësuar format e komunikimit me publikun, duke mos e përdorur prej vitesh këtë mundësi komunikimi dhe përfshirje të qytetarëve.

Televizionet lokale janë format më tradicionale të komunikimit midis Bashkisë dhe KB të Vlorës. Zakonisht njoftimet kryesore, transmetimet e mbledhjeve të KB, por edhe konsultimet publike transmetohen vazhdimisht nga TV lokale në Vlorë. Bashkia dhe KB komunikojnë drejtëpërdrejt me qytetarët kur duan të përcjellin mesazhe të rëndësishme dhe kanë bashkëpunim të mirë me gazetarët lokalë. Tradicionalisht ky komunikim është një formë e pëlqyer e qytetarëve, kryesisht ndjekësit janë moshat e mëdha, por së fundmi pas pandemisë gjithçka transmetohet live dhe gjendet edhe në kanalin e youtube.

Njoftimet direkte bëhen përmes administratorëve të lagjeve në zonat rurale, dhe përmes administratorëve të NJA-ve dhe kryepleqve të fshatrave. Është një tjetër formë që ndodh zakonisht për çështje të informimit, njoftimit dhe konsultimit publik. Edhe pse ky lloj komunikimi rezulton në shumë raste problematik, ai është një prej formave që përdoret gjerësisht në Bashkinë Vlorë dhe KB. Ndërsa qytetarët ankohen se nuk janë informuar/përfshirë në kohë, ky lloj komunikimi i minutës së fundit, përmes grupeve të whatsapp-it, vazhdon të dominojë duke mbyllur kanalet e komunikimit dhe të ndërveprimit midis qytetarëve dhe institucioneve lokale.

Format e Pjesëmarrjes:

Takimet individuale janë forma më e përhapur e pjesëmarrjes që Bashkia Vlorë dhe KB realizon shpesh me persona të caktuar. Ditë të caktuara të javës kryetari i bashkisë pret në zyrën e tij qytetarë ose grupime qytetarësh që kërkojnë bashkëpunim ose ndërveprim me institucionin e bashkisë. Gjithsesi ndikuar edhe nga pandemia, këto takime janë zvogëluar në numër. Ndërsa anëtarë të KB realizojnë takime të ndryshme për çështje me interes të komunitetit, por mungesa e sallës së KB sjell vështirësi. Ndërkohë si Bashkia ashtu dhe KB nuk kanë ndonjë informacion për të ndarë me komunitetin se ku janë vendet dhe oraret e takimit.

Dëgjesat Publike janë forma më e suksesshme që Bashkia dhe KB realizojnë. Zakonisht për çështje të rëndësishme kur duhet të konsultohet publiku të dyja institucionet i realizojnë së bashku proceset. Vetëm vlen për t'u theksuar që janë të pakta rastet kur këto dëgjesa ndodhin, kryesisht për procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje, ose në rastin e konsultimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Për dëgjesat publike është mirë që të dyja institucionet të publikojnë më parë kalendarin e tyre, ose edhe kur e publikojnë duhet ta realizojnë në bazë të planifikimit që vetë ato bëjnë.

Takimet në terren me komunitetin janë një tjetër formë e konsultimit dhe pjesëmarrjes qytetare. Zakonisht ato publikohen në faqet e mediave sociale pasi janë realizuar dhe shumë pak punohet për të monitoruar zbatimin e çështjeve që trajtohen në këto takime në terren.

Grupet e këshillimit janë grupe që kryesisht Bashkia Vlorë përdor për të marrë mendimet e qytetarëve. Grupe të bizneseve lokale, grave, të rinjve dhe operatorëve turistikë, etj. janë ato më aktivet që bashkia merr mendimin për çështje të caktuara. Ndërsa KB e përdor pak këtë formë këshillimi, por në raste të veçanta ka organizuar takime me drejtori të Bashkisë për një tematikë të caktuar, ku janë marrë komente dhe sugjerime e një pjesë e tyre janë reflektuar edhe në vendimmarrjen e tij apo të Bashkisë.

Konsultimi dhe marrja e mendimeve përmes formave elektronike është një tjetër formë që është përdorur vitin e kaluar nga KB Vlorë për marrjen e mendimit qytetar për buxhetin afatmesëm 2022-2024.


7. GJETJE NGA ANKETIMI ME BASHKITË DHE KESHILLAT BASHKIAKË

Për përgatitjen e këtij raporti u intervistuan në intervista ballë për ballë 10 (5F/5M) persona kyç nga të cilët pesë punonjës të Bashkisë Vlorë (Drejtoria e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun: Koordinatorën për të Drejtën e Informimit dhe Koordinatorën për Njoftimin e Konsultimin Publik dhe administratore të rajoneve), ndërsa nga Këshilli Bashkiak janë realizuar pesë intervista me kryetaren e KB dhe kryetarë të komisioneve të këtij këshilli.

Të intervistuarit janë persona të cilët punojnë ose përfaqësojnë pozicione të rëndësishme në lidhje me proceset e të drejtës së informimit, njoftimit dhe konsultimin publik me qytetarët.

Anketimi synon të evidentojë dhe sjellë në vëmendje situatën aktuale të informimit dhe pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrjen lokale si dhe të analizojë të gjitha format dhe instrumentat që përdor institucioni i Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak për informimin dhe bashkëpunimin me qytetarët.

Perceptimet mbi Informimin, Njoftimin dhe Konsultimin në Vendimmarrjen Vendore.



Në zbatim të detyrimeve të parashikuara në Ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” në Bashkinë Vlorë të anketuarit janë pyetur mbi perceptimin e tyre mbi rëndësinë e njoftimit në vendimmarrjen vendore.




Siç vërehet edhe nga përgjigjet, rëndësia e këtij komponenti domethënës të mirëqeverisjes në nivel vendor për të gjithë punonjësit e bashkisë dhe anëtarët e KB vlerësohet si një proces shumë i rëndësishëm nga 80% dhe i rëndësishëm rreth 20% nga të intervistuarit.

Perceptimi i tyre lidhet me rëndësinë që ka procesi i njoftimit publik në kohë, si një mekanizëm që lejon që të zbatosh detyrimet që rrjedhin nga ligji.

E drejta për informim është e garantuar në përputhje me Ligjin 119/2014, ku secili ka të drejtën dhe mund të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore dhe insitucionet publike duhet të garantojnë transparencën dhe të drejtën e informimit për të gjithë. Të gjithë të intervistuarit në Bashki e vlerësojnë si shumë të rëndësishëm procesin e informimit, ndërsa përfaqësuesit e KB e ndajnë këtë vlerësim midis shumë të rëndësishëm 60% dhe të rëndësishëm në 40%. Pyetjet ofrojnë perceptimin e punonjësve dhe të zgjedhurve vendorë mbi procese kaq të rëndësishme që duhet të përfshijnë edhe qytetarët. Në përgjigje vihen re diferenca të lehta midis stafit të Bashkisë dhe anëtarëve të KB, ku një pjesë e ka detyrim ligjor, ndërsa pjesa tjetër percepton se ka rëndësi, por pa specifikuar mënyrat e duhura që duhet të zbatohen.

Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe Konsultimin publik”, si dhe Ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendorë”, mbështesin dhe nxisin procese gjithëpërfshirëse të konsultimit me komunitetin. Stafi i bashkisë e vlerëson shumë të rëndësishëm procesin e konsultimit me publikun dhe po ashtu edhe anëtarët e KB e vlerësojnë si një mënyrë mjaft efikase për të kryer rolin e tyre si të zgjedhur vendorë. Konsultimi publik edhe pse në forma jo të unifikuara, ka një rëndësi të veçantë për të intervistuarit.



Kuadri Ligjor për Njoftimin, Informimin dhe Konsultimin në Nivel Vendor

Të pyetur mbi kuadrin ligjor dhe njohuritë që kanë mbi të, përfaqësuesit e bashkisë shprehen se kanë njohuri shumë të mira ose të mira, ndërsa kur i pyet si dhe sa praktikohen këto njohuri në realitet, vihen re faktorë të shumtë që pengojnë që njohuritë shumë të mira që ata disponojnë të përkthehen në shërbime më cilësore dhe gjithëpërfshirëse për qytetarët. Në perceptimin qytetar, administrata ka marrë shumë kompetenca duke lënë mënjanë shërbimet më thelbësore ndaj

qytetarit, dhe ndërkohë që shumë pak praktika të mira vazhdojnë të realizohen dhe shumë elementë të ligjit edhe pse ekzistojnë në letër, nuk zbatohen më.

Përsa i përket këshilltarëve të KB Vlorë, edhe ata shprehen për njohuri të thelluara mbi legjislacionin në këtë fushë, biles ata tregojnë edhe për rregulloret e aprovuara, ndërsa në 2021 në një situatë problematike midis bashkisë Vlorë dhe KB, gjithë njohuritë e thelluara nuk patën mundësi të ofronin zgjidhje për qytetarët, por sollën vetëm një konflikt të shtuar dhe të vazhduar midis dy strukturave. Gjithsesi pas kapërcimit të situatave bllokuese ndaj njëri-tjetrit, tanimë marrëdhënia vazhdon e qetë, ndërsa njohuritë mbi legjislacionin vazhdojnë dhe rriten.

Që ligjet të jenë efektive dhe të zbatueshme, ato duhet të gëzojnë jo vetëm njohjen dhe kuptueshmërinë e profesionistëve të cilët i përdorin ato në punën e përditshme. Qytetarët shpesh ankohen për zbatimin e mirë dhe të barabartë të ligjit, ndërsa punonjësit e administratës për nevojë në fonde, personel dhe mjete.



Të pyetur për vlerësimin e kuadrit ligjor që lidhet me njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore, të intervistuarit nga Bashkia dhe KB Vlorë, për kuadrin ligjor mbi njoftimin, informimin dhe konsultimin në nivel vendor, janë shprehur si më poshtë:

- 60% është i qartë dhe i plotë;
- 30% është i qartë por jo i plotë;
- 10% i paqartë dhe i plotë.

Stafi i bashkisë, i pyetur nëse ka nevojë për rishikim apo plotësime të kuadrit ligjor, shprehet se nuk ka nevojë, legjislacioni është i qartë dhe i plotë, ndërsa zbatimi i tij vazhdon të mbetet një sfidë që duhet kapërcyer në marrëdhëniet me qytetarët. Ajo çfarë mbetet të përmirësohet janë urdhërat e punës ose udhëzuesit për implementimin e proceseve të informimit, njoftimit dhe konsultimit (rasti i udhëzuesit të BP).

Rregulloret e Këshillit Bashkiak: Ndërsa anëtarët e KB Vlorë shprehen se kanë miratuar në periudhën e pandemisë pesë rregullore që janë: Rregullorja e Peticioneve dhe Iniciativave qytetare; Rregullorja për strukturat komunitare dhe ndërveprimin e tyre në këshillin bashkiak; Kodin e sjelljes dhe i parandalimit të konfliktit të interesave të këshilltarit bashkiak; Rregulloren për marrëdhëniet e këshillit me publikun dhe mediat; Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e strukturës komunitare në fshat; Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e këshillit të bashkisë Vlorë (së fundmi kanë bërë ndryshime në rregulloren e funksionimit të KB, në muajin prill 2022, duke paraqitur një rregullore me ndryshime të nevojshme) duke miratuar

një set me dokumente cilësore, mbështetur nga Bashki të Forta. Këto instrumenta synojnë të rregullojnë dhe lehtësojnë procese dhe funksione të caktuara të këshillit bashkiak.

Si përfundim nga vëzhgimet e grupit të punës, mund të theksojmë se kuadri ligjor vazhdon të përmirësohet, por mbetet ende problem zbatimi në praktikë i tij për Bashkinë dhe për KB.

Koordinatori për Konsultimin Publik dhe Transparencën

Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin publik parashikohet nga dy ligje, 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik sipas ligjit ka një rol të rëndësishëm dhe detyra të përcaktuara qartë në procesin realizimit të njoftimeve dhe konsultimeve publike. Të dhënat e koordinatorit afishohen në faqen zyrtare të bashkisë. Nga monitorimet e kryera në faqen zyrtare web të Bashkisë Vlorë, janë të publikuara të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik. Ndërsa është e paqartë prej vitesh, nëse personi përgjegjës i ka të gjitha kompetencat të kryejë këtë detyrë dhe rekomandohet që për këtë pozicion të jetë një punonjës i dedikuar. Në rastin e koordinatorit të transparencës, në Bashkinë Vlorë mungon si pozicion, duke e kryer këtë detyrë koordinatori për informimin publik. Është ende e paqartë si ndahen detyrat e punës midis stafit të Bashkisë Vlorë, ndërsa proceset janë duke u zhvilluar në mënyrë sipërfaqësore.

Rekomandohet që koordinatori i programit të transparencës të zgjedhet dhe të kryejë detyrat e tij që rrjedhin nga ligji.

Bashkëpunimi midis KB dhe Bashkisë për procesin e njoftimit dhe informimit, theksojmë faktin se proceset zakonisht i udheheq Bashkia, ndërsa KB me raste herë bashkëpunon dhe herë të tjera jo. Bashkëpunimi deri më tani ka ndodhur për dëgjesat publike të Buxhetimit me Pjesëmarrje; Buxhetit Afatëmesëm për nxjerrjen e njoftimeve dhe shpërndarjen e tyre në mediumet e bashkisë.

Instrumentat për Njoftimin e Qytetarëve

Për njoftimin e qytetarëve në lidhje me çështje të ndryshme Bashkia Vlorë duket se përdor një tërësi formash në mënyrë që informacioni të shkojë tek çdo target grup. Vërehet se format më të përdorura janë lajmërimet në mediat sociale dhe mediat lokale (100%), njoftimet në momentet e fundit me grupe whatsapp-i (50%), si dhe në lajmërimet/takimet individuale (40%) ose përmes emailit të bashkisë.

E njëjta situatë ndodh edhe për KB të Vlorës, ku forma tradicionale është ajo e njoftimit në mediat sociale. Lajmërimet individuale nëpërmjet postës elektronike kryhen për çështje apo njoftime specifike për persona të caktuar dhe përdoren në raste të caktuara.

Ndarja e informacionit me qytetarët realizohet si më poshtë;

- lajmërimet publike të afishuara në ambientet e bashkisë (40%)
- lajmërimet në mediat audiovizive (60%)
- lajmërimet në mediat sociale (100%)
- lajmërimet individuale nëpërmjet postës elektronike (40%)
- lajmërimet grupet e whatsapp-it (50%)
- lajmërimet individuale (adminsitratorë rajonesh/kryepleq) 40%

Regjistri Elektronik

Mbajtja dhe publikimi i regjistrit elektronik është një detyrim ligjor që duhet përmbushur nga çdo institucion publik, por që në praktikë nuk gjen zbatim në çdo bashki në vend. 70% e të intervistuarve shprehën se ka një regjistër elektronik, i cili përditësohet sistematikisht dhe mbahet në arkivin e bashkisë. Lidhur me përgjegjësitë e mbajtjes dhe përditësimit të tij ata nuk kishin informacione të qarta kush nga drejtoritë në bashki realizon këtë proces.

Të pyetur më tej nëse ky regjistër është i publikuar online, 70% konfirmuan se janë në djeni të regjistrit elektronik, por nuk kishin informacione nëse përditësohej. Ndërkohë që ata shprehën se procesverbali i takimeve me publikun mbahet dhe në disa raste dëgjesat janë publikuar në faqen web. Të pyetur për numrin total të lajmërimeve të publikuara gjatë vitit 2021, nuk patëm mundësinë të gjeneronim numrin e saktë të tyre, kjo për larmishmërinë e formave që perdoren për lajmërimet dhe përfshirja në të e disa drejtorive të bashkisë.

Këshilli Bashkiak: publikon njoftimet për mbledhjet kryesisht në mediat sociale dhe në disa raste edhe në faqen web të bashkisë. Çdo njoftim përmban të dhëna të mjaftueshme me datën, vendin, orën dhe rendin e ditës, ndërsa aktet e miratuara shpallen në faqen zyrtare të internetit dhe në stendën e njoftimeve publike të Bashkisë Vlorë. Nga monitorimet në faqen web të Bashkisë, regjistrat elektronik janë publikuar dhe ndahen në:

- regjistri për ankesa, kërkesa dhe vërejtje
- regjistri i projekt-akteve për konsultim publik të këshillit bashkiak
- regjistri publik për transparencën e mbledhjeve të këshillit
- regjistri i peticioneve dhe iniciativave qytetare

Instrumentat e Informimit

Sa i përket mjeteve që përdor Bashkia Vlorë për informimin e qytetarëve, vihet re rëndësia e faqes zyrtare të bashkisë si dhe mediat sociale ku 100% e të intervistuarve i shohin si mjete të rëndësishme për informimin e qytetarëve. Më pas si format më të përdorura për informimin e qytetarëve 75% janë mediat audio-vizive dhe takimet individuale. Punonjësit e bashkisë referojnë se çdo dokument gjendet në faqen web të bashkisë, por pasi bën kontrollin vihet re se fjala më e përdorur në kërkime është “Ky dokument nuk u gjet”.

E njëjta situatë ndodh edhe për dokumentet e KB, kryesisht për disa prej materialeve që janë në format e rregulloreve, ndërsa pjesa tjetër është e hedhur në mënyrë kaotike, me data të publikimit të pa rifreskuara.

Të anketuarit janë pyetur për sfidat dhe vështirësitë që ndeshin në njoftimin dhe informimin e publikut. Ata janë shprehur se komunikimi me qytetarët duhet përmirësuar, duke qenë se gjithmonë e më pak qytetarë po marrin pjesë në iniciativa apo takime, ndërsa duhen gjetur mjete alternative që komunikimi të jetë i vazhdueshëm. Zgjidhja e vetme shihet nga administratorët e rajoneve apo të Nj.A-ve, apo kryepleqve.

Aksesi i qytetarëve në dokumenta

Të pyetur për aksesin që kanë qytetarët për të marrë dokumenta apo informacione të ndryshme, të gjithë të intervistuarit u shprehën se ai mund të merret lehtësisht përmes kërkesave për informim.

Publikimi i akteve në faqen zyrtare

Edhe pse administrata e bashkisë dhe KB prodhojnë dokumente në faqen e bashkisë, rekomandohet që faqja të bëhet interaktive. Ajo nuk është miqësore dhe për të marrë një akt zyrtar duhet të harxhosh kohë dhe njohuri. Punonjësit e IT që administrojnë faqen e bashkisë duhet të përgjigjen në kohë çdo detyrimi ligjor, por edhe të sigurojnë aksesin e qytetarëve në informacione.

Hartimi i Programit të Transparencës

Ligji 119/2014 detyron autoritetet publike për të përgatitur, publikuar dhe përditësuar Programin e Transparencës duke synuar rritjen e aksesit në informacione zyrtare. Programi Transparencë është dokumenti që përmbledh tërësinë e informacioneve që duhet të jepen në mënyrë aktive nga bashkia pa kërkesë. Programi i Transparencës publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkisë në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”, në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë dhe njësive administrative.

Të gjithë të intervistuarit shprehën se ka një program transparence, miratuar nga KB, por aksesin në këtë program është i vështirë dhe në mjaft raste krijohet përshtypja se nuk ka program. Gjithsesi, është për t'u vlerësuar fakti që ka përpjekje që të përmirësohet kjo situatë, por pikë së pari Bashkia Vlorë duhet të riformatojë faqen e internetit, duke siguruar akses në informacione dhe shërbime për qytetarët e saj.

Të intervistuarit u shprehën në masën 100% se bashkia harton dhe publikon programin e transparencës si dhe raportet vjetore për transparencën.

Nga monitorimi i kryer, programi i transparencës si dhe hartimi dhe publikimi i raportve vjetore për transparencën në vendimmarrje mungon dhe deri më sot nuk është paraqitur mundësia për të konsultuar ndonjë raport transparence nga Bashkia Vlorë.

Përsa i përket Këshillit Bashkiak, është e paqartë nëse këtë raport duhet ta prodhojnë vetë, apo bashkia Vlorë. Gjithsesi në të dyja rastet nuk ka ndonjë raport të identifikuar nga grupi që realizon monitorimin. Të vetmet dokumente të identifikuara janë raportet vjetore të KB Vlorë, për vitin 2020-2021, ndërsa kur kërkon të njihesh me përmbajtjen e tyre, dokumentet nuk hapen.

Gjithashtu në kuadër të planifikimit të punës dhe transparencës, KB Vlorë miraton në mbledhjet e tij edhe planin vjetor të punës, të cilin pas një monitorimi të thjeshtë kemi vënë re që vetë ky këshill nuk e zbaton.

Trajnimet mbi Detyrimet Ligjore mbi Informimin Publik

Të pyetur nëse kanë marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin e publikut, rreth 65% e të intervistuarve janë përgjigjur se kanë zhvilluar trajnime të tilla dhe 35% nuk kanë marrë trajnime. Po ashtu, ato janë shprehur se ka gjithmonë nevojë për të tilla trajnime në organizimin e tryezave të diskutimit duke ndarë eksperiencat apo praktikat e mira apo për të bërë propozime konkrete për përmirësimin e akteve nënligjore.

Këshilli Bashkiak i pyetur nëse kanë marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore dhe informimin public, të gjithë janë përgjigjur se kanë marrë. Por u shprehën se gjithmonë ka nevojë për trajnime të ndryshme, për shkëmbim eksperiencash me këshilla të tjerë bashkiakë si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- ✓ Proceset e njoftimit, informimit dhe konsultimit publik vlerësohet nga institucioni i Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Vlorë si procese shumë të rëndësishme, prandaj këto shërbime duhet të fuqizohen.
- ✓ Zyra me një Ndalesë që pritet të hapet së shpejti, pritet të përmirësojë informimin e publikut dhe shërbimet që kjo bashki ofron në mënyrë të unifikuar. Pavarësisht mënyrës së funksionimit të marrëdhënieve me publikun në institucion, mund të vlerësohet pozitivisht funksionimi i zyrave të pritjes dhe shërbimit të qytetarëve, si dhe procesit kërkesë-ankesë në përputhje konform me ligjin.
- ✓ Rekomandohet të ketë koordinim më të mirë mes Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak.
- ✓ Ndërkohë që shumë problematika lidhen me zbatimin jo efektiv të ligjit (sidomos për njoftimin dhe konsultimin publik), të intervistuarit evidentuan nevojën për rishikim apo amendim të legjislacionit përkatës.
- ✓ Krijim procedurash të mirëstrukturuara.
- ✓ Bashkia Vlorë i ndërton komunikimet publike me qytetarët nëpërmjet disa mënyrave si: komunikimi i drejtpërdrejtë, të cilin e zhvillon nëpërmjet takimeve në terren apo dëgjesave publike, komunikimi në mediat lokale (TV), si dhe komunikimin në mediat sociale kryesisht në Facebook.
- ✓ Pavarësisht arritjeve të deritanishme, realizimi i procesit të konsultimit publik ka ende nevojë për përmirësime. Kjo kërkon rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t'u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.
- ✓ Bashkia dhe Këshilli Bashkiak duhet të zgjidhë përfundimisht çështjen e zgjedhjes së sekretarit të Këshillit Bashkiak. Mungesa e këtij pozicioni ngadalëson punën dhe reflektohet në probleme serioze që kanë të bëjnë me informimin, njoftimin dhe konsultimin publik.
- ✓ Bashkia duhet të përditësojë rregullisht mediat në mënyrë që ndikimi dhe informimi tek qytetarët të jetë sa më i madh. Ndërtimi i një plani strategjik komunikimi me mediat do të ndihmonte në targetimin e një grupi sa më të madh të audiencës. Ndërtimi i komunikimit të duhur në këto media siguron informimin, orientimin dhe përfshirjen demokratike të qytetarëve në qeverisjen vendore.

- ✓ Mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë një nga aktivitetet më të rëndësishme. Ato mundësojnë komunikimin me qytetarët për trajtimin e problematikave dhe çështjeve me interes për komunitetin, por për një sërë arsyesh pjesëmarrëja në to është e pakët. Prandaj, shihet i nevojshme përmirësimi i këtij aspekti, nëpërmjet konsultimit më të gjerë për marrjen e mendimit qytetarëve.
- ✓ Në përputhje edhe me Ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Bashkia Vlorë e ka ndërtuar faqen e vet zyrtare, një strukturë e mirëfilltë për publikimin e informacioneve që lidhen me institucionin. Por nga vëzhgimi del që kjo faqe ka nevojë të përditësohet më shpesh në disa fusha.
- ✓ Faqja e internetit të Bashkisë Vlorë ka nevojë urgjente të përmirësohet, të jetë miqësore dhe dokumentet e prodhuara si PBA/Buxheti Vendor apo Plani i Përgjithshëm Vendor të ri-ngarkohen në këtë faqe.
- ✓ Procesi i dixhitalizimit të shumë shërbimeve krijon vështirësi në aksesin e informacionit apo shërbimit për shumë qytetarë, prandaj duhet të krijohet infrastruktura e nevojshme për komunikim me të gjithë banorët.
- ✓ Rekomandohet të shtohen burimet financiare e njerëzore, paralelisht me rritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe asistencës teknike.

9. ANEKSE

PYETËSOR ME DREJTUES DHE NËPUNËS TË BASHKISË

Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social”.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” po monitoron zbatimin e kontratave sociale të nënshkuara me 12 bashki përmes dy projekteve që shkrihen te njëri-tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Rrjeti synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien në nivel vendor.

Kërkojmë bashkëpunimin tuaj për plotësimin e këtij pyetëtori. Gjetjet e këtij sondazhi dhe rekomandimet e dala prej tij do të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies dhe përmirësimin e përfshirjes së qytetarëve në Bashkinë tuaj.

Bashkia _____
Drejtoria _____

1. Në opinionin tuaj si drejtues/nëpunës, sa i rëndësishëm është njoftimi, informimi dhe konsultimi në vendimmarrjen vendore?

Perceptimi	Shumë i rëndësishëm	I rëndësishëm	Disi i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Aspak i rëndësishëm
Njoftimi	1	2	3	4	5
Informimi	1	2	3	4	5
Konsultimi	1	2	3	4	5

2. A e njihni bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore?

Njohuritë	Shumë mirë	Mirë	Disi	Pak	Aspak
Kuadri ligjor	1	2	3	4	5

3. Cili është vlerësimi juaj për kuadrin ligjor mbi njoftimin dhe informimin e publikut në nivel vendor? (mund të zgjidhni më shumë se sa një alternativë)

- Është i qartë dhe i plotë
- Është i qartë, por jo i plotë
- Është i paqartë, por i plotë
- Është i paqartë dhe jo i plotë

4. Nëse mendoni që ka nevojë për rishikim apo plotësime, cilat do të ishin rekomandimet tuaja në këtë drejtim?
-
-

5. A ka koordinator/e për njoftimin dhe konsultimin publik në Bashki dhe a është ky i vetmi pozicion që mbulon?

Po Jo

6. A ka koordinator/e për transparencën në Bashki dhe a është ky i vetmi pozicion që mbulon?

Po Jo

7. Cilat janë mjetet që përdorni për njoftimin e qytetarëve për përfshirjen e tyre në vendimmarrje? Ju lutem specifikoni (mund të bëni më shumë se një zgjedhje).

- Lajmërim publik afishuar në ambjentet e bashkisë
- Lajmërim në mediat audio-vizive lokale
- Lajmërim në mediat sociale (Facebook, etj)
- Lajmërim individual përmes postës
- Lajmërim individual përmes postës elektronike
- Tjetër

8. Sa njoftime të publikuara në tabelat e lajmërimeve dhe online janë bërë gjatë vitit 2021? Ju lutem specifikoni.

9. A keni regjistër elektronik dhe a përditësohet ai sistematikisht?

Po Jo

10. Kush është përgjegjës për përditësimin e tij?

11. A është i publikuar ky regjistër (online)?

Po Jo

12. Cilat nga mjetet dhe format e mëposhtme përdorni për informimin e qytetarëve? Ju lutem specifikoni (mund të bëni më shumë se një zgjedhje):

- Zyrat me Një Ndalesë (One Stop Shop)
- Këndet e informimit në ambjentet e bashkisë/njësive administrative
- Faqja zyrtare e bashkisë
- Regjistri elektronik
- Mediat sociale
- Botimet e bashkisë
- Materiale informuese (fletëpalosje, etj)
- Mediat audio-vizive lokale
- Tjetër

13. A kanë mundësi qytetarët të marrin apo aksesojnë lehtësisht dokumenta dhe/apo informacione që ju duhen pranë bashkisë?

Po Jo

14. A publikohen aktet e Bashkisë tuaj në faqen zyrtare të internetit?

Po Jo

15. A afishohen aktete e bashkisë tuaj në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.

Po Jo

16. A keni hartuar dhe publikuar programin e transparencës?

Po

Jo

17. A keni hartuar dhe/apo publikuar raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes?

Po

Jo

18. Nëse po, a përfshijnë ato informacion mbi:

- numrin e akteve të miratuara nga Bashkia përgjatë vitit;
- numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
- numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;
- numrin e takimeve publike të organizuara.

19. Cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që keni ndeshur për njoftimin dhe informimin e publikut?

20. Cilat do të ishin rekomandimet tuaja për ta përmirësuar më tej zbatimin e këtij procesi në të ardhmen?

21. A keni marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin publik?

Po

Jo

22. Cilat do të ishin nevojat për trajnime në të ardhmen në lidhje me informimin publik, njoftimin dhe konsultimin?

FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!

PYETËSOR ME KËSHILLTARË BASHKIAK

Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social”.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” po monitoron zbatimin e kontratave sociale të nënshkuara me 12 bashki përmes dy projekteve që shkrihen të njëri-tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Rrjeti synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien në nivel vendor.

Kërkojmë bashkëpunimin tuaj për plotësimin e këtij pyetëtori. Gjetjet e këtij sondazhi dhe rekomandimet e dala prej tij do të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies dhe përmirësimin e përfshirjes së qytetarëve në Bashkinë tuaj.

Bashkia _____

1. Në opinionin tuaj si këshilltar vendor, sa i rëndësishëm është njoftimi, informimi dhe konsultimi në vendimmarrjen vendore?

Perceptimi	Shumë i rëndësishëm	I rëndësishëm	Disi i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Aspak i rëndësishëm
Njoftimi	1	2	3	4	5
Informimi	1	2	3	4	5
Konsultimi	1	2	3	4	5

2. A e njihni bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore?

Njohuritë	Shumë mirë	Mirë	Disi	Pak	Aspak
Kuadri ligjor	1	2	3	4	5

3. Cili është vlerësimi juaj për kuadrin ligjor mbi njoftimin dhe informimin e publikut në nivel vendor?
- I qartë dhe i plotë
- I qartë, por jo i plotë

- I paqartë, por i plotë
- I paqartë dhe jo i plotë

4. Keni rregullore dhe procedura të brendshme të miratuara për realizimin e procesit të njoftimit dhe informimit? Nëse po, ju lutem specifikoni.

5. Cili është vlerësimi juaj për rregulloret e Këshillit Bashkiak (“Marrëdhënjet e KB me publikun dhe median” dhe “Paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare”)?

- Të qarta dhe të plota
- Të qarta, por jo të plota
- Të paqarta, por të plota
- Të paqarta dhe jo të plota

6. Nëse mendoni që ka nevojë për rishikim apo plotësime, cilat do të ishin rekomandimet tuaja në këtë drejtim?

7. A ka bashkëpunim mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë për procesin e njoftimit dhe informimit?

Po Jo

8. Nëse po, si realizohet ky bashkëpunim?

9. A publikohet njoftimi për mbledhjen e këshillit në vende të caktuara për këtë qëllim dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore?

Po Jo

10. Ne dijeninë tuaj, a përmban njoftimi datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes?

Po Jo

11. Në dijeninë tuaj, aktet e Këshillit Bashkiak publikohen/shpallen në:

- faqen zyrtare të internetit
- në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik
- tjetër

12. A ka Këshilli Bashkiak burimet e nevojshme për realizimin e njoftimit dhe informimit të publikut?

Po Jo

13. Në dijeninë tuaj, cilat janë mjetet që përdor Këshilli për njoftimin dhe informimin e publikut:

- Lajmërim publik afishuar në ambjentet e bashkisë
- Lajmërim në mediat audio-vizive lokale
- Lajmërim në mediat sociale (Facebook, etj)
- Lajmërim individual përmes postës apo takimeve direkte
- Lajmërim individual përmes postës elektronike
- Tjetër

14. Në dijeninë tuaj, a ka një regjistër elektronik të publikuar dhe përditësuar rregullisht?

Po Jo

15. Në dijeninë tuaj, a ka hartuar dhe publikuar Bashkia programin e transparencës?

Po Jo

16. Në dijeninë tuaj, a hartohen dhe publikohen raporte vjetore të punës së Këshillit për transparencën në procesin e vendimmarrjes?

Po Jo

17. A keni marë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin publik?

Po Jo

18. Cilat do të ishin nevojat për trajnime në të ardhmen në lidhje me informimin publik, njoftimin dhe konsultimin?

FALEMINDERIT!